



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2024:214406
Datë: 14.09.2024
Numri i dokumentit: 06161293

C.nr. 2223/24.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË - Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin Migjen Kastrati, në çështjen juridike – kontestimore të paditësit R.Znga Peja, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Ylberza Glllogjani - Krasniqi, avokat në Pejë, kundër të paditurës, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve me seli në Prishtinë, me bazën juridike, kompensim - llogaritje e inflacionit në pension, vlera e kontestit 500 euro, jashtë seancës me datën 14.09.2024 bie këtë:

A K T V E N D I M

I. KONSIDEROHET e tërhequr padia e paditësit R.Z nga Peja, kundër të paditurës, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve me seli në Prishtinë, me bazën juridike, kompensim - llogaritje e inflacionit në pension, vlera e kontestit 500 euro.

A r s y e t i m

Paditësi përmes të autorizuarës së tij, pranë kësaj gjykate me datën 01.08.2024 ka parashtruar padi kundër të paditurës, me bazën juridike, kompensim - llogaritje e inflacionit në pension, vlera e kontestit 500 euro.

Gjykata me rastin e shqyrtimit paraprak të padisë dhe provave prezentë në lëndë, ka konstatuar se paditësi padisë nuk i ka bashkangjitur vërtetimin mbi taksen gjyqësore të paguar e që kërkohet në kuptim të dispozitës së nenit 253.4 të Ligjit për Procedurën Kontestimore - LPK-së.

Gjykata duke vepruar sipas padisë së paditësi ia ka dërguar vërejtjen për pagesën e taksës e datës 21.08.2024, të autorizuarës se tij, ashtu që e njëjta të paguaj taksën gjyqësore për padi, në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes, duke e njoftuar për pasojat e mos pagesës së taksës, të cilën vërejtje e autorizuar e paditësi e ka pranuar me datën 22.08.2024, gjë që vërtetohet nga flete kthesa që gjendet në shkresat e lëndës.

Gjykata ka vepruar në kuptim të Udhëzimit Administrativ NR.02/2017 për Ndryshimin e Udhëzimit Administrativ Nr.01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore dhe paditëses i ka dërguar vërejtjen për pagesën e taksës gjyqësore për padi, sipas nenit 5, 5.2, 5.3 dhe 5.5, 5.5.2 i këtij Udhëzimi Administrativ dhe në bazë të dispozitës së nenit 253 pika 4 e 5 të LPK-së.

Sipas dispozitës së nenit 253.1, të LPK-së shprehimisht parashihet se çka duhet të përmbajë padia, ndërsa sipas dispozitës së nenit 253.4, të këtij ligji shprehimisht parashihet se ‘’paditësi ka për detyrë që padisë t’i bashkëngjisë vërtetimin mbi taksën gjyqësore të paguar’’, ndërsa sipas dispozitës së nenit 253.5 të këtij ligji, shprehimisht parashihet se ‘’në qoftë se paditësi nuk e paguan taksën gjyqësore të përcaktuar për padi, e as pas vërejtjes së dërguar nga gjykata edhe pse nuk ekzistojnë konditat për lirim nga pagimi i taksës gjyqësore do të konsiderohet se padia është e tërhequr.’’

Meqenëse pala paditëse nuk ka vepruar në kuptim të vërejtjes për pagesën e taksës gjyqësore për padi dhe gjykatës nuk i ka dorëzuar kërkesë - prova që ekzistojnë konditat për lirim nga detyrimi i pagimit të taksës gjyqësore për padi, e duke u mbështetur në depozitat e nenit 253.1, 4 dhe 5, dhe nenin 387.1, pika w), të LPK- së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE PEJË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
2024:214406,C.nr.2223/24 i dt. 14.09.2024

G j y q t a r i
Migjen Kastrati

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e përmes kësaj Gjykate.